



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2849/10 prot.

Datë 13.11.2025

V E N D I M
Nr. 1678/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.11.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 1559/2025, datë 30.10.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-61260-09-12-2025, me objekt: “Loti 1 – Aparatura për banken e gjakut”, me fond limit 775,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 25.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK, me NIPT L62217032L dhe adresë: Rruga Allaman Dervishi, Pallati Classic A.M. Nr.31, Kthesa e Kamzës, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor** Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës, me adresë: Lagjia nr.8, Rr.A.Goga, Durrës.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 30.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1559/2025 ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-61260-09-12-2025, me objekt: “Loti 1 – Aparatura per banken e gjakut”, me fond limit 775,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 25.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.*
2. *Autoriteti kontraktues të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Albadent Group” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 466/33 prot., datë 07.11.2025 protokolluar me tonën nr. 2849/7 prot., datë 12.11.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.1559/2025 datë 30.10.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-61260-09-12-2025, me objekt: “Loti 1 – Aparatura per banken e gjakut”, me fond limit 775,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 25.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.

.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1 Me shkresën nr. 466/33 prot., datë 07.11.2025 protokolluar me tonën nr. 2849/7 prot., datë 12.11.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.1559/2025 datë 30.10.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-61260-09-12-2025,

me objekt: “Loti 1 – Aparatura per banken e gjakut”, me fond limit 775,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 25.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.1559/2025 datë 30.10.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës objekt ankimi, në zbatim të vendimit Nr.1559/2025 datë 30.10.2025, të këtij komisioni.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-61260-09-12-2025, me objekt: “Loti 1 – Aparatura per banken e gjakut”, me fond limit 775,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 25.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

